

**KONTRATË PËR HARTIMIN E AKTIT TË THEMELIMIT TË
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GREEN ENERGY” SH.P.K.**

Sot, më datë 10.11.2021 (dy mijë e njëzet e një), pala e mëposhtme:

1. Z. Xhesi Loci I biri Besnikut, lindur në datë 18.07.1998 në Bërxullë, e me banim në Bërxullë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtësi i lehtënjofimit me numër personal J80718035F,

Ka vendosur të nënshkruajë këtë Akt Themelimi të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“GREEN ENERGY” SH.P.K.**, aktiviteti i së cilës rregullohet nga ky Akt Themelimi, Statuti dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 1
ORTAKËT THEMELUES**

1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar krijohet nga ortakët si mëposhtëm:

1. Z. Xhesi Loci I biri Besnikut, lindur në datë 18.07.1998 në Bërxullë, e me banim në Bërxullë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtësi i lehtënjofimit me numër personal J80718035F,

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

- 2.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, si dhe të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar.
- 2.2 Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**NENI 3
EMËRTIMI**

3.1 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **“GREEN ENERGY” SH.P.K.**

**NENI 4
SELIA**



- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 9, Rruga "Asim Vokshi", Alb building 2t.

NENI 5 OBJEKTI

- 5.1 Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është:

Projektim, ndertim, instalim dhe tregtimi i sistemeve të energjisë së rinovueshme, parqeve të fermave diellore, parqet e erës nëpërmjet turbinave dhe të sistemeve hidro elektrike të shfrytëzuara për vetë ose për të tjerët. Ndertimin e centraleve prodhuese për prodhimin e energjisë së rinovueshme. Projekte elektromekanike dhe gjeotermale që sjellin kursime të energjisë në ndërtesat industriale të kompanive private, publike dhe shtetërore. Prodhim dhe shitje të energjisë termike të përfituar nga perpunimi i mbetjeve urbane. Kryerja e studimeve për projektet në fushën e energjisë së rinovueshme, ngrohjes, gazit, duke përfshirë pajisjet hidraulike dhe instalimet elektrike. Importi-eksporti i produkteve në fushën e energjisë së rinovueshme, ngrohjes, kondicionimit, paneleve diellore të ujit, sistemeve të gazit, sistemeve të ventilimit, ndertimit të pajisjeve hidraulike. Instalimin dhe mirëmbajtjen e mallrave dhe produkteve të shoqërisë përmes servisit teknik. Prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet e energjisë së rinovueshme diellore nëpërmjet zbatimit dhe menaxhimit të projektit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse të saj. Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar të të gjitha lejeve dhe licensave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyrë të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria ka të drejtë të ushtroje çdo lloj aktiviteti të parashikuar nga Ligji në përputhje me rregullat e dispozitat në fuqi. Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj në baze të autorizimeve dhe/ose lejeve përkatëse të leshuara nga organet kompetente të fushës. Shit-blerjen e energjisë elektrike tek operatorët lokal apo ndërkombëtarë, sipas legjislacionit dhe lejeve të organeve kompetente.

NENI 6 KOHËZGJATJA

- 6.1 Shoqëria ka një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi..

NENI 7 KAPITALI THEMELTAR

- 7.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë i ndarë zotëruar nga ortakut i vetëm. Çdo kuotë njësi jep të drejtën e një vote. Kapitali themeltar i shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga Ortakët.
- 7.2 Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga Ortaku, si më poshtë vijon:

- **Ortaku Xhesi Loci**, zotëron 1 kuotë të barabartë me 100% të kapitalit themeltar.



**NENI 8
ADMINISTRIMI**

8.1 Me këtë akt emërohet Administrator i shoqërisë:

Z. **Xhesi Loci** I biri Besnikut, lindur në datë 18.07.1998 në Bërxulle, e me banim në Bërxulle, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtësi i lehtënjofimit me numër personal J80718035F

Administratori do të ushtrijë të gjitha kompetencat e administrimit, në përputhje me parashikimet e Statutit të shoqërisë dhe të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.

**NENI 9
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në përputhje me ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, si dhe me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.
- 9.2 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statut, si dhe në legjislacionin përkatës shqiptar.
- 9.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri, në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKËT

XHESI LOCI

Xhesi Loci 